



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI JURIDIK

Nr. _____ Prot.

Himarë, më ____ / ____ / 2026

Shtojca 11

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

Data: **07.07.2026**

Drejtuar: **Qamil Doka, NIPT L81924026A, Rruga Kadillari, Dyqan dhe Magazin, Nr. 47–Tiranë.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO X

OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO X

Tipi i Kontratës: **Mallra**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **e Hapur.**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-87846-05-28-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës.: **Blerje materiale elektrike dhe hidraulike.**

Kohëzgjatja: **12 (dymbëdhjetë) muaj.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **29.05.2026**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: **Nr. 35 datë 01.06.2026**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X**

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. ERVIN LUZI

K71707007Q

Vlera: 9 900 000 (nëntë milionë e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH dhe shumatorja e çmimeve për njësi: nuk ka paraqitur

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO X

2. VASSA J62903470T

Vlera: nuk ka paraqitur dhe shumatorja e çmimeve për njësi: 224 517,5 (dyqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë presje pesë) Lekë pa TVSH
OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3. NIKA TRADING SA M13817805J

Vlera: 12 173 000 (dymbëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë) Lekë pa TVSH dhe shumatorja e çmimeve për njësi: nuk ka paraqitur
OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

4. Qamil Doka L81924026A

Vlera: 15 727 360 (pesëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH dhe shumatorja e çmimeve për njësi: 296 865 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH;
OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. ERVIN LUZI K71707007Q

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Arsyeja e skualifikimit: Nuk paraqiti mostrat për produktet e kërkuara duke mos plotësuar kriterin e pikës 2.3.4. Nuk ka paraqitur shumatoren e çmimeve për njësi.

2. VASSA J62903470T

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Në Formularin e Vetëdeklarimit operatori ekonomik nuk ka specifikuar dokumentacionin konkret provues për secilën deklaratë të paraqitur. Mungesa e referimit të dokumenteve mbështetëse nuk mundëson identifikimin dhe verifikimin e provave që vërtetojnë përmbushjen e kërkesave të deklaruara në formular. Operatori ekonomik nuk ka përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 të dokumenteve të tenderit, sipas të cilit kërkohet vetëdeklarimi i origjinës së mallit dhe i kompanisë prodhuese. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se operatori ekonomik ka depozituar vetëm një deklaratë të përgjithshme, pa specifikuar për secilin artikull origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese përkatëse. Deklarimi i paraqitur nuk mundëson identifikimin e prodhuesit dhe vendit të origjinës për secilin produkt të ofertuar, duke e bërë të pamundur verifikimin e përputhshmërisë së mallrave me kërkesat e dokumenteve të tenderit. Për rrjedhojë, deklarimi i paraqitur nuk përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.3, pasi mungon informacioni i detajuar për secilin artikull objekt furnizimi, çka përbën mospërmbushje të një kriteri të veçantë të kualifikimit dhe sjell skualifikimin e ofertës. Mospërmbushja e specifikime teknike të mostrave të paraqitura: Artikulli nr. 21: Produkti i ofertuar nuk përmbush kërkesat e specifikimeve teknike, pasi temperatura e ngjyrës e deklaruar është 6 500 K, ndërkohë që në dokumentet e tenderit është kërkuar temperaturë

ngjyre 10 000 K. Ky devijim tregon se karakteristikat e produktit të ofertuar nuk janë në përputhje me parametrat teknikë të kërkuar.

Artikulli nr. 22: Produkti i ofertuar nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara, pasi fluksi i ndriçimit është 2 700 lumen, ndërkohë që është kërkuar minimumi 3 000 lumen. Gjithashtu, temperatura e ngjyrës e deklaruar është 6 500 K, ndërkohë që është kërkuar 6 000 K. Po ashtu, tensioni i punës i ofruar është 220–240 V, ndërkohë që specifikimet teknike kërkojnë interval tensioni 85–265 V AC. Për rrjedhojë, produkti i ofertuar nuk plotëson parametrat teknikë të përcaktuar.

Artikulli nr. 23: Për këtë artikull është ofertuar një ndriçues LED me fuqi 18 W, ndërkohë që në specifikimet teknike është kërkuar fuqi 19 W. Fluksi i ndriçimit i deklaruar është 1 880 lumen, ndërkohë që është kërkuar 2 000 lumen. Gjithashtu, jetëgjatësia e deklaruar e produktit është 25 000 orë pune, ndërkohë që dokumentet e tenderit kërkojnë një jetëgjatësi minimale prej 50 000 orësh pune. Këto mospërputhje tregojnë se produkti i ofertuar nuk i plotëson kërkesat teknike minimale.

Artikulli nr. 24: Produkti i ofertuar nuk përmbush kërkesat teknike, pasi fluksi i ndriçimit është 1 950 lumen, ndërkohë që është kërkuar 2 100 lumen. Diametri i jashtëm i deklaruar është Ø240 mm, ndërkohë që është kërkuar Ø215 mm, ndërsa diametri i brendshëm është Ø225 mm, ndërkohë që është kërkuar Ø195 mm. Përmasat dhe karakteristikat e produktit nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara.

Artikulli nr. 44: Temperatura e ngjyrës e deklaruar është 6 500 K, ndërkohë që është kërkuar 7 000 K. Gjithashtu, në dokumentacionin teknik të paraqitur nuk jepen të dhëna mbi efikasitetin e ndriçuesit gjatë punës dhe nuk deklarohet indeksi i paraqitjes së ngjyrave (CRI). Mungesa e këtyre parametrave nuk lejon verifikimin e përputhshmërisë së produktit me kërkesat teknike.

Artikulli nr. 45: Produkti i ofertuar paraqet temperaturë ngjyre 6 500 K, ndërkohë që në specifikimet teknike është kërkuar temperaturë ngjyre 8 000 K. Për rrjedhojë, karakteristikat e produktit nuk janë në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit.

Artikulli nr. 46: Temperatura e ngjyrës e deklaruar është 6 500 K, ndërkohë që është kërkuar 8 000 K. Gjithashtu, dokumentacioni teknik nuk përmban të dhëna mbi jetëgjatësinë minimale të orëve të punës së produktit, duke e bërë të pamundur verifikimin e përmbushjes së këtij parametri teknik.

Artikulli nr. 47: Në mostrën e paraqitur nuk përcaktohet fluksi i ndriçimit në lumen, çka nuk lejon verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e specifikimeve teknike. Gjithashtu, përmasat e projektorit të ofertuar nuk janë në përputhje me përmasat e kërkuara në dokumentet e tenderit.

Artikulli nr. 48: Në mostren e paraqitur nuk përcaktohet fluksi i ndriçimit në lumen, duke e bërë të pamundur vlerësimin e këtij parametri. Gjithashtu, tensioni i punës i deklaruar është 220–240 V, ndërkohë që në specifikimet teknike është kërkuar intervali 175–250 V. Për rrjedhojë, produkti i ofertuar nuk përputhet plotësisht me kërkesat teknike.

Artikulli nr. 49: Fluksi i ndriçimit i produktit të ofertuar është 3 000 lumen, ndërkohë që në specifikimet teknike është kërkuar 2 700 lumen. Parametri i deklaruar nuk përputhet me karakteristikat teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

3. NIKA TRADING SA

M13817805J

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nuk plotëson kriterin e kualifikimit të pikës 2.3.3 pasi nuk ka paraqitur prodhuesin dhe origjinën e mallit për secalin produkt. Deklarimi i paraqitur nuk mundëson identifikimin e prodhuesit dhe vendit

të origjinës për secilin produkt të ofertuar, duke e bërë të pamundur verifikimin e përputhshmërisë së mallrave me kërkesat e dokumenteve të tenderit. Nuk ka paraqitur shumatoren e çmimeve për njësi. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostër për artikullin nr. 24 “Ndriçues LED tavan gipsi 24W”, duke mos përmbushur kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, e cila parashikon detyrimin për paraqitjen e mostrave për produktet e kërkuara. Nga shqyrtimi i mostrave dhe dokumentacionit teknik të paraqitur rezultojnë këto mospërputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit:

Artikulli nr. 21: Temperatura e ngjyrës e produktit të ofertuar rezulton 4 000 K, ndërkohë që në specifikimet teknike është kërkuar temperaturë ngjyre 10 000 K. Ky parametër nuk përmbush kërkesat teknike të autoritetit kontraktor.

Artikulli nr. 22: Tensioni i punës i deklaruar është 220–240 V, ndërsa në specifikimet teknike është kërkuar intervali 85–265 V AC. Gjithashtu, jetëgjatësia minimale e produktit është 20 000 orë pune, në një kohë që dokumentet e tenderit kërkojnë minimumi 30 000 orë pune.

Artikulli nr. 23: Fluksi i ndriçimit i deklaruar është 1 600 lumen, ndërkohë që është kërkuar minimumi 2 000 lumen. Po ashtu, jetëgjatësia e produktit rezulton 30 000 orë pune, ndërsa specifikimet teknike kërkojnë një jetëgjatësi minimale prej 50 000 orësh.

Artikulli nr. 44: Temperatura e ngjyrës e deklaruar është 6 500 K, ndërkohë që është kërkuar 7 000 K. Klasa energjetike e produktit është E, ndërsa në specifikimet teknike është kërkuar klasë energjie A++.

Gjithashtu, tensioni i punës 220–240 V nuk përputhet me intervalin e kërkuar 85–265 V.

Artikulli nr. 45: Temperatura e ngjyrës së produktit të ofertuar është 6 500 K, ndërkohë që në specifikimet teknike është kërkuar temperaturë ngjyre 8 000 K.

Artikulli nr. 46: Temperatura e ngjyrës rezulton 2 700 K, ndërkohë që kërkesa e dokumenteve të tenderit është 8 000 K. Gjithashtu, jetëgjatësia minimale e deklaruar është 15 000 orë pune, ndërsa është kërkuar minimumi 30 000 orë pune.

Artikulli nr. 47: Dokumentacioni teknik i paraqitur nuk përmban të dhëna mbi jetëgjatësinë minimale të produktit, duke mos lejuar verifikimin e përmbushjes së këtij parametri. Gjithashtu, dimensionet e projektorit të ofertuar nuk janë në përputhje me përmasat e përcaktuara në specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit.

Artikulli nr. 49: Temperatura e ngjyrës e produktit të ofertuar është 6 500 K, ndërkohë që në specifikimet teknike është kërkuar temperaturë ngjyre 2 700 K, duke rezultuar në mospërputhje me parametrat teknikë të kërkuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Qamil Doka me adresë: Rruga Kadillari Dyqan dhe Magazin Nr. 47 – Tiranë**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **15 727 360** (pesëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) **Lekë pa TVSH** është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Themistokli FOTO